

## Kodi i Sjelljes së Subjekteve

Qëndresa Qytetare është e përkushtuar në garantimin e transparencës, paanësisë dhe përgjegjësisë së praktikave të saj prokuruese dhe ruajtjen e standardeve të larta të integritetit dhe ndershmërisë.

Ky dokument përcakton pritshmërinë tonë ndaj furnizuesve, dhe rrjetit të tyre furnizues, mbi ofrimin e produkteve dhe shërbimeve ndaj Qëndresës Qytetare. Subjektet janë të këshilluar që së bashku me nën-kontraktuesit e tyre të familjarizohen me Kodin e Sjelljes në mënyrë që të sigurohet një bashkëpunim sa më i mirë me Qëndresën Qytetare.

### **Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të:**

#### **1. Përmirësojnë cilësinë:**

Të mundohen në mënyrë aktive të demonstrojnë dhe përmirësojnë rezultatet, si dhe të ulin kostot përgjatë marrëveshjeve afatgjata dhe/ose porosive blerëse.

Të vendosin çmime të ndershme e të përshtatshme të cilat reflektojnë kërkesat dhe rreziqet.

Të kërkojnë vazhdimisht përmirësim në reduktimin e mbetjeve dhe të rrisin efikasitetin në organizatën dhe rrjetin e tyre të furnizimit.

Të fitojnë shifra të ndershme por jo të ekzagjeruara.

#### **2. Sillen me profesionalizëm dhe integritet:**

Të jenë të ndershëm dhe realistë mbi kapacitetet dhe aftësitë e tyre gjatë bërjes së ofertës.

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të inkurajojnë dhe të punojnë me subjektet dhe nën-kontraktuesit e tyre, për të siguruar që edhe ata përpiqen të plotësojnë kriteret e Kodit të Sjelljes, dhe të jenë të gatshëm ta demonstrojnë këtë kur iu kërkohet.

Të bashkëpunojnë në mënyrë që të ndërtohen marrëdhënie profesionale biznesi, përfshirë këtu edhe me stafin e Qëndresës Qytetare.

#### **3. Jenë të përgjegjshëm:**

Të aplikohen çmime të cilat i justifikojnë pagesat nëpërmjet rezultateve, si dhe reflektojnë një ndarje më të balancuar të riskut të performancës

Të mbajnë përgjegjësi për shërbimin dhe rolin e tyre, duke përfshirë këtu ndershmërinë kur gjërat nuk shkojnë siç duhet, në mënyrë që të merren mësim.

#### **4. Mbështesin Qëndresën Qytetare:**

Të vendoset theksi tek ndërtimi i kapaciteteve vendore duke kërkuar forma për të zhvilluar tregjet dhe institucionet vendore, si dhe të shmanget përdorimi i marrëveshjeve ekskluzive kufizuese.

Të shpërndahen dhe transferohen risitë dhe njohuritë mbi praktikatat e mira në mënyrë që të maksimizohet ndikimi i përgjithshëm i zhvillimit.

Të mirëkuptohet mjedisi sfidues në të cilin punojmë, si dhe të merren masa për menaxhimin e pasigurisë dhe ndryshimeve në një formë që mbron investimin.

#### **5. Zbatojnë Konventat Ndërkombëtare të Punës:**

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj, si dhe nën-kontraktuesit e tyre, të zbatojnë Konventat Ndërkombëtare të Punës.

Të ndalohet çdo lloj forme e punës së detyruar dhe jo vullnetare.

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të mos punësojnë:

- fëmijë nën 14 vjeç, ose edhe ata që janë mbi atë moshë, do të jenë të lejuar sipas legjislacionit shqiptar, dhe
- persona nën 18 vjeç të cilëve mund t'u rrezikohet shëndeti, siguria, apo morali nga natyra dhe rrethanat e punës që do të kryejnë.

Qëndresa Qytetare nuk toleron asnjë formë diskriminimi mbi bazat e racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, etnisë, moshës apo paafësive fizike gjatë procesit të punësimit.

Dorespektuar legjislacioni i shtetit për sa i përket pagave, orëve të punës, lirisë së asociimit dhe të drejtës për t'u organizuar dhe negociuar në mënyrë kolektive.

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të mbështesin dhe respektojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të sigurohen që të mos bëhen palë e abuzimit të tyre.

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të garantojnë se ambientet e tyre të punës janë të sigurta dhe të shëndetshme.

#### **6. Të kenë politika të forta mjedisore:**

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj të kenë politika efektive mjedisore të cilat janë në përputhje me rregullat dhe legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e mjedisit.

Subjektet do tëndërmarrin iniciativa të cilat promovojnë përgjegjësi më të madhe mjedisore si dhe të inkurajojnë përdorimin e teknologjive pro-mjedisore.

Kur i jepet mundësia, subjektet do tëpërdorin një sistem menaxhimi cilësor të licencuar.

**7. *Anti-Korrupsioni dhe Ryshfetet:***

Qëndresa Qytetare pret që subjektet e saj t'i përmbahen standardeve më të larta të sjelljes morale dhe etike përkundrejt fenomeneve të zhvatjes, mashtrimit dhe rryshfeteve.

Të zbulohet çfarëdolloj rasti kur (mund të) shfaqet konflikti i interesit.

Të aplikohet toleranca zero ndaj korrupsionit dhe mashtrimit, nëpërmjet menaxhimit me cilësi të lartë.

Emri i Subjektit

Emri dhe Titulli i Përfaqësuesit të Subjektit

Firma

Data

Vula